

Dëgjoni përfundimin e gjithë ligjëratës (Predikuesit 11, 12)

Tani ne jemi gati për të parë konkluzionet në të cilat Salomoni arriti, përmbledhjen e gjithë mësimëve që ai mësoi nga jeta dhe sprovat e saj. Salomoni provoi gjithçka dhe mësoi, si nga hallet dhe gabimet, ashtu edhe nga dituria dhe përvoja, se cilat janë gjërat më të rëndësishme dhe më të parëndësishme në jetë.

Në mënyrë metodike dhe gati shkencore, Salomoni iu vu punës për të gjetur lumturinë. Në fund të jetës së tij, Salomoni përgatiti këtë raport, për të bërë të njohur përfundimet e «kërkimit» të tij. Me mijra njerëz pas Salomonit kanë bërë prova të njëjta dhe kanë arritur përfundime të njëjta, por asnjë nga këto përfundime nuk ka qenë i formuluar kaq mirë dhe, për më tepër, i frymëzuar nga Perëndia. Fjalët e Salomonit janë shumë të çmuara. Edhe në qoftë se bota do të vazhdojë të ekzistojë për miliona vite të tjerë, mesazhi i tij do të mbetet po aq i vërtetë dhe i dobishëm sa ka qenë që në fillim.

Në librin e Predikuesit, kapitujt 11 dhe 12, bëhet e qartë se përgjigjet e pyetjeve të jetës gjenden te Perëndia. Perëndisë i përket toka dhe gjithë gjërat në të (Psalmeve 24:1). Ne të gjithë jemi krijesat e Perëndisë. Në qoftë se duam të dimë se pse jemi këtu në këtë tokë, ne duhet të lexojmë librin e Krijuesit, Biblën.

MBËSHTETUNI TE PERËNDIA (11:1–6)

Kapitulli 11 fillon në këtë mënyrë: «Hidh bukën tënde mbi ujërat, sepse pas shumë kohe do ta gjesh përsëri.» Të hedhësh bukën në ujë duket e pakuptimtë. Buka do të lundrojë mbi ujë për pak minuta dhe pastaj do të zhduket përgjithmonë. Atëherë, pse Salomoni e përdor këtë shembull kaq të pakuptimtë? Ai po përpiqet të thotë se disa gjëra duken kaq të pakuptimta, saqë mendojmë se nuk ka asnjë arsye për t'i bërë ato. Ne nuk mund t'i shikojmë gjithmonë pasojat e veprimeve tona. Ne nuk jemi në gjendje që të matim rezultatet e jetës tonë, sepse nuk e dimë se si Perëndia do t'i përdorë veprat tona. Ne nuk mund ta kuptojmë mënyrën se si vepron Perëndia. Pali tha: «Unë mbolla, Apoli ujiti, po Perëndia i bëri të rriten» (1 Korintasve 3:6). Ne do të korrim fryte, po të vazhdojmë të punojmë për Perëndinë, madje edhe kur puna jonë na duket, neve apo të tjerëve, e padobishme.

Më tej, lexojmë këshillën: «Jepu pjesë shtatë, madje edhe tetë vetave, sepse ti nuk e di se çfarë fatkeqësie mund të të ndodhë mbi tokë» (11:2). Numrat «shtatë» dhe «tetë» përdoren si numra të pacaktuar, duke nënkuptuar «jepu sa më shumë njerëzve që të mundesh». Ne duhet t'u bëjmë mirë të tjerëve pa pushim, sepse ne vetë nuk e dimë kur do të kemi nevojë për ndihmë. Ne nuk mund të ndryshojmë rrjedhën e natyrës. Në rast se retë janë plot me shi, ato e derdhin atë mbi tokë (11:3).

Ne nuk e dimë se ku do të bjerë një pemë. Vetëtima mund ta godasë apo era mund ta ç'rrënjosë. Ajo mbetet aty ku bie (11:3). Ngjarjet natyrore, mbi të cilat nuk kemi asnjë kontroll, mund të shkaktojnë që secili prej nesh të ketë nevojë për ndihmë.

Duke menduar në këtë mënyrë, kristianët e hershëm me gëzim i shitën pasuritë e tyre për t'ua dhënë paratë apostujve, me qëllim që këta të fundit t'ua shpërndanin atyre që ishin në nevojë (Veprat 2:44–45, 4:32–37). Ndërkohë, nëse ata që jepnin do të ndodheshin në nevojë, do të ndihmoheshin nga të tjerët. Kjo është mënyra që Perëndia ka paracaktuar për të mbrojtur njerëzit e tij.

Ata njerëz që e bazojnë jetën dhe aktivitetin e tyre tërësisht në ligjet e natyrës që na rrethon ndoshta kurrë nuk do të arrijnë të përfundojnë ndonjë gjë. Në qoftë se i kushtojmë shumë rëndësi erës, ndoshta nuk do të mundim të mbjellim farën. Në qoftë se shikojmë retë që mbliidhen, mund të vendosim që të mos korrim, nga frika se do të bjerë shi. Unë nuk po them të injorojmë rreziqet e natyrës. Kjo do të ishte marrëzi. Por, në anën tjetër, duke qenë shumë të shqetësuar dhe të preokupuar me problemet që na rrethojnë çdo ditë, vëmendja jonë shpërqëndrohet dhe ne nuk arrijmë të çojmë asgjë deri në fund.

Ne nuk mund të kuptojmë gjithçka që do të na ndodhë në jetë (11:5). Nuk e dimë se si punon shpirti i njeriut apo se si kockat e një fëmije formohen në barkun e nënës, përpara lindjes së fëmijës. Dhe as që mund të kuptojmë punët e Perëndisë, i cili i shkakton të gjitha këto. Por ne nuk duhet të lejojmë që gjërat që s'i kuptojmë të na pengojnë të kryejmë punën tonë.

Ne duhet t'i besojmë Perëndisë dhe të vazhdojmë punën që Ai na ka dhënë. Ne duhet të fillojmë të punojmë në mëngjes dhe të vazhdojmë të punojmë, po aq shumë, edhe në darkë. Ne asnjëherë nuk e dimë se çfarë aktiviteti do të jetë më frutdhënës për ne. Gjithçka varet nga mënyra se si Zoti do të bekojë përpjekjet tona. Mund të jetë që fara e mbjellë në mbrëmje të jetë po aq frytdhënëse sa ajo e mbjellë në mëngjes (11:6).

GËZOHUNI NË ZOTIN SOT (11:7–10)

Është e mrekullueshme që ta gëzosh jetën (11:7–8). Te vargu 7 fjalët: «që shohin diellin» në përgjithësi nënkuptojnë: «të gëzosh jetën». Vazhdimisht Salomoni iu referua kohës që njeriu jeton

mbi tokë si koha «nën diellin». Dhe ditët e jetës përmbi këtë tokë janë ato ditë në të cilat sytë mund të shikojnë dritën e diellit. Në këtë mënyrë, Salomoni donte të thoshte: «Është me të vërtetë gjë e madhe që të jesh i gjallë.»

Në vargun 8 na thuhet që të jetojmë aq sa të mundemi dhe ta gëzojmë jetën çdo ditë. Duke mbajtur në mendje se një ditë do të vdesim, duhet të inkurajohemi ta jetojmë këtë jetë sa më mirë. Shprehja «ditët e territ», në vargun 8, ndoshta i referohet ditëve në varr (shikoni 9:10). Përjetësia është e gjatë në krahasim me jetën këtu në tokë. Salomoni i referohet varrit si «shtëpia e përjetshme» e njeriut te 12:5. Ne e dimë se do të vdesim dhe ky fakt duhet të na bëjë që ta jetojmë jetën ashtu si na e ka dhënë Perëndia. Kjo rithekson faktin se ne, në të vërtetë, nuk e kuptojmë rëndësinë e jetës këtu në tokë dhe, si rrjedhim, nuk dimë si ta jetojmë këtë jetë, nëse nuk njohim më parë vdekjen dhe kuptimin e saj.

Më tej, lexojmë: «Gëzohu, pra, o i ri, në rininë tënde, le të gëzohet zemra jote në ditët e rinisë sate» (11:9). Salomoni po thoshte: «Gëzohuni ju që jeni të rinj. Perëndia do që ju ta shijoni jetën. Kini një zemër të gëzueshme. Hapni sytë dhe shikoni gjërat e mira rreth vetes, por mos u gënjeni duke besuar se gëzimi i vërtetë i jetës gjendet në kënaqësitë e mëkatit. Kujtohuni se do të jepni llogari përpara Perëndisë për çdo veprim tuajin.»

Të gëzosh jetën nuk do të thotë liri për të kryer çdo lloj mëkati, me qëllimin e vetëm për të kënaqur trupin apo mendjen tënde (Hebrenjve 11:25). Perëndia do që ne ta flakim trishtimin nga zemrat tona, duke jetuar të gëzuar. Ai gjithashtu do që ne ta heqim të keqen nga trupi ynë. Të bësh një jetë të gëzuar do të thotë të bësh një jetë të drejtë. Të përpiqesh për të jetuar me gëzim, ndërkohë që merr pjesë në kënaqësitë e mëkatit, është e padobishme.

KUJTONI PERËNDINË NË RININË TUAJ (12:1–8)

Mënyra më e mirë për të nderuar Perëndinë është të fillojmë t'i shërbejmë Atij, përpara se pleqëria të trokasë në derën tonë. Salomoni shkroi: «Por kujto Krijuesin tënd në ditët e rinisë sate, para se të vijnë ditët e këqija dhe të arrijnë vitet për të cilat ke për të thënë: “Nuk gjej asnjë kënaqësi në to”» (12:1). Është shumë e vështirë t'i gëzohesh jetës në moshë të thyer, sidomos kur nuk beson në

Perëndinë. Shumica e atyre që i afrohen pleqërisë pa qenë besimtarë të Tij, plaken dhe vdesin në të njëjtën gjendje: jobesimtarë. Është më e vështirë t'i bindesh Perëndisë në moshë të thyer sesa kur je i ri. Faktet nga jeta tregojnë se, sa më shumë plaket një njeri, aq më e vështirë bëhet që ai t'i besojë Perëndisë. Në të gjithë botën, kudo që ungjilli predikohet, të rinjtë janë ata që i përgjigjen mesazhit më pozitivisht.

Pse është më e vështirë që njerëzit të kthehen te Perëndia në një moshë të thyer? Nga vargu 2 deri te vargu 7 ne zbulojmë një sërë metaforash që përshkruajnë rezultatet e plakjes:

Para se të errësohet dielli, drita, hëna dhe yjet, dhe të kthehen retë pas shiut; në moshën gjatë së cilës rojtarët e shtëpisë dridhen, njerëzit e fortë përkulen, ato që bluajnë nuk punojnë më se kanë mbetur pak, ata që shikojnë nga dritaret errësohen dhe portat mbi rrugë mbyllen; kur pakësohet zhurma e mokrës, dikush çohet me këngën e një zogu, dhe gjithë bijat e këngës dobësohen; kur dikush ka frikë nga lartësia dhe nga tmerret e rrugës; kur bajamja lulëzon, karkaleci është një peshë, dhe dëshira pakësohet, sepse njeriu shkon në banesën e tij të përjetshme dhe qaramanët enden rrugëve. Kujto Krijuesin tënd përpara se të këputet kordoni prej argjendi, të thyhet vazoja prej ari, të thyhet shtamba te burimi dhe të bëhet copë-copë çikriku në pus, dhe pluhuri t'i kthehet tokës siç ishte më parë dhe fryma t'i kthehet Perëndisë që e ka dhënë.

Trupi dhe aftësitë e njeriut ndryshojnë kur ai arrin në moshë të thyer. Duart (rojtarët e shtëpisë) fillojnë të dridhen dhe këmbët (njerëzit e fortë) fillojnë të përkulen. Dhëmbët (ata që bluajnë) nuk punojnë më dhe sytë (dritaret) errësohen. Trupi është lodhur aq sa nuk mund t'i përgjigjet udhëzimeve të trurit si më parë. Njerëzit në moshë të thyer shpesh dekurajohen, kur mendojnë se duhet të jetojnë për Perëndinë. Arsyetimi i tyre është se ata tashmë i kanë harxhuar vitet më të mira të jetës, duke jetuar pa Perëndinë. Ata kanë frikë se nuk kanë më energji apo kohë për t'ia kushtuar Perëndisë. Ata mendojnë se nuk do të ishte e drejtë po t'i kërkonin Perëndisë t'i falte dhe t'i pranonte në atë moshë të thyer. Natyrisht, kjo nuk është e vërtetë. Perëndia dëshiron të falë dhe të pranojë të gjithë ata njerëz që me sinqeritet pendohen dhe i përulën Atij, qofshin të rinj apo të vjetër në moshë.

Salomoni vazhdon përshkrimin e njeriut të moshuar. Veshët nuk i dëgjojnë më (dhe portat mbi rrugë mbyllen; kur pakësohet zhurma e mokrës), megjithatë i moshuari fle kaq lehtë se edhe cicërима e një zogu mund ta zgjojë atë nga gjumi në mëngjes.

Zëri humbet volumin e tij (dhe gjithë bijat e këngës dobësohen). Frika nga lartësia shtohet me moshën. Flokët thinjen (bajamja lulëzon). Ai nuk mund të mbartë më pesha të rënda (karkaleci është një peshë), dhe dëshirat e tij pakësohen në çdo drejtim. Ai e di se për pak do të vijë dita kur ai do të shkojë në shtëpinë e përjetshme, i ndjekur nga njerëzit që do të vajtojnë për të, rrugës për në varreza.

Te 12:6 vdekja ilustron me dy shembuj: «Kujto Krijuesin tënd përpara se të këputet kordoni prej argjendi, apo të thyhet vazoja prej ari, apo të thyhet shtamba te burimi dhe të bëhet copë-copë çikriku në pus.» Kur kordoni prej argjendi i jetës këputet, atëherë vazoja prej ari bie dhe bëhet copë-copë¹. Në shembullin tjetër shtamba te burimi thyhet, dhe çikriku bëhet copë-copë. Trupi kthehet në pluhurin prej të cilit u krijua (Zanafilla 2:7) dhe fryma do t'i kthehet Perëndisë që e dha (12:7–8). Çfarëdo qoftë që planifikojmë të bëjmë për Perëndinë, duhet ta bëjmë përpara se të arrijmë vdekjen. Çdo përgatitje për përjetësinë duhet bërë përpara se përjetësia të vijë. Njeriu bën një jetë të kotë, kur ai nuk e përdor këtë jetë për t'u përgatitur për përjetësinë.

MËSONI TË VËRTETËN (12:9–14)

Pavarësisht nga problemet e tij, Predikuesi, Salomoni, arriti ta ndante mençurinë e tij me të tjerët. Ai mblodhi shumë fjalë të urta për t'ua mësuar njerëzve. Ai kërkoi rrugën e drejtë për të komunikuar fjalët e tij të së vërtetës dhe të së drejtës (12:9–10).

Fjalët e të urtëve janë si hostenë që prekin ndërgjegjen dhe motivojnë veprimin (12:11). Hosteni është një shkop i mprehtë dhe me majë që përdoret për të vënë në lëvizje qetë. Këto fjalë të urta ishin si gozhdë, të përdorura nga mësuesit, për të ngulitur mësimin në mendjet e nxënësve.

Salomoni më pas e paralajmëron birin e tij që të mendohet seriozisht për çfarë do të dëgjojë dhe do të mësojë nga njerëzit rreth e rrotull tij (12:12). Mendime të panumërta shprehen nga njerëz që pretendojnë se i dinë të gjitha. T'i studiosh ato dhe të vendosësh se cilat janë të vërteta apo jo mund të jetë një proces i lodhshëm, por i domosdoshëm. Ne duhet të analizojmë gjithçka që na thuhet. Gjithçka që nuk është e vërtetë, nuk është dituri.

Për shumë vjet Salomoni, me gjithë diturinë dhe mençurinë e tij, kërkoi që të zbulojë kuptimin

e jetës. Në fund të librit të Predikuesit, ai shkroi: «Të dëgjojmë, pra, përfundimin e gjithë ligjëratës: «Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e tij, sepse kjo është tërësia e njeriut. Sepse Perëndia do të vërë të gjykohet çdo vepër, edhe çdo gjë që është fshehur, qoftë e mirë apo e keqe»» (12:13–14).

KONKLuzioni

Përfundimi i Solomonit duhet të jetë përfundimi ynë: «Ki frikë nga Perëndia dhe respekto urdhërimet e Tij.» Ky është gjithë qëllimi i jetës! Rruga e drejtë për ne është të jetojmë për Perëndinë dhe të jemi

gati për Ditën e Gjykimit (Mateu 25:31–46). Ne do t'i japim përgjigje Perëndisë për gjërat që bëjmë, madje edhe për gjërat sekrete, pavarësisht nëse ato janë të mira apo të këqija. Pali foli për ditën kur «Perëndia do të gjykojë të fshehtat e njerëzve me anë të Jezu Krishtit» (Romakëve 2:16). Ata që kanë frikë nga Perëndia dhe i respektojnë urdhërimet e Tij do të kenë për çfarë të gëzohen kur të vijë ajo ditë (1 Pjetër 4:13).

SHËNIME

¹ Kordoni prej argjendi dhe vazoja prej ari janë: kordoni ku varet llampa me vaj, vazoja është vetë llampa.

Autor: *J. L. May*
Marrë nga studimi: “*Cili është kuptimi i jetës*”
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara